



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GRACANICA

Numri i lëndës: 2024:212488  
Datë: 24.01.2025  
Numri i dokumentit: 06753634

**K.nr.292/2024**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GRAQANICË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**, me gjyqtarin Rustem Begolli, me zyrtarën ligjore Blerta Bekteshi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse, kundër të pandehurit A. B. K., për kundërvajtjen nga neni 117.2 lidhur me nenin 249 par.2 të LSKRK-së, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.08/L-186, pas shqyrtimit gjyqësor, me datë **21.01.2025**, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I PANDEHURI:**

**A. K. nga i ati B.**, i lindur me datë 14.03.1981 në fshatin Konjuh, me vendbanim në rrugën Sinan Vitia .....fshati ..... KK Lipjan ku edhe jeton , bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptarë shtetas i Republikës së Kosovës me numër personal .....

**ËSHTË PËRGJEGJËS**

**Sepse:**

Me datën ..... rreth orës 04.20, kam qenë në rrugën Qagllavicë Graqanicë, duke e drejtuar automjetin e tipit VW Passat me targa të regjistrimit ....., ku ka ardhur deri te aksidenti, në atë mënyrë që me pjesën e përparme të anës së majtë të veturës së tij e ka goditur në pjesën e pasme anën e djathtë automjetin e tipit VW Passat me targa të regjistrimit ..... të cilin e ngiste L..Af. N.. Me atë rast janë shkaktuar dëme materiale, ndërsa lëndime të lehta trupore ka pësuar B. G. nga L.dh L. N. nga Prishtina rruga Ali Hadri .

me veprim të këtyllë ka kryer kundërvajtjen nga neni 117.2 lidhur me nenin 249 par.2 të LSKRK-së, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.08/L-186. Andaj gjykata duke vendosur në bazë të neneve 3,7, 8, 9, 27 par.1 pika 1.2, 29, 31 dhe 35 të Ligjit për Kundërvajtje nr.05/L-087, i shqipton:

## **D Ë N I M**

**Me gjobë në shumën prej 130euro (njëqind e tridhjetë euro), të cilën gjobë ka për të paguar në afat prej 15 ditësh pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së, Nr.1000-4300-70000-518, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.**

Në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5 euro, në të njëjtën me gjobën në shërbimin e arkës së gjykatës.

Palët e dëmtuar **B. G. nga Lipjani dh L. N. nga Prishtina rruga A. H. ,** për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civilo-juridik.

Ekzekutimin do të bëhet sipas ligjit në fuqi.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

### **A r s y e t i m**

Policia e Kosovës- NJRKR Fushë Kosovë, parashtror kërkesën nr. .... me datë 16.05.2024, për fillimin e procedurës kundërvajtjese kundër të pandehurit A.B. K., për kundërvajtjen nga neni 117.2 lidhur me nenin 249 par.2 të LSKRK-së, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.08/L-186.

Gjykata mbajti seancën gjyqësore me marrjen në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi: E pranoj kundërvajtjen të cilën e kam shkaktuar dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen do të jem shumë e kujdesshëm në komunikacion. Po ashtu kërkoi nga gjykata që të më shqiptoi një dënim më të butë.

Gjykata duke vepruar konform nenit 49 të LK-së dhe meqenëse i pandehuri e ka pranuar kundërvajtjen, gjeti se pranimi i përgjegjësive është i plotë dhe në pajtim me provat e bashkangjitura në shkresat të lëndës, me deklaratat e dhëna, dhe se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës kundërvajtjese, nga neni 120.1 dhe 225 par.2, të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor Nr.05/L-088, për çka edhe shpalli përgjegjës dhe u dënua me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e shqiptimit të gjobës mori për bazë rrethanat e parapara me nenin 31 të Ligjit mbi Kundërvajtje, peshën e veprës kundërvajtjese, pasojat, rrezikshmërinë shoqërore, shkallën e përgjegjësive së të pandehurit, ndërsa si rrethanë lehtësuese vlerësoi personalitetin sjelljen e të pandehurës, pranimin e kundërvajtjes, pendimin për veprimin e bërë, duke aplikuar nenin 35 të LK-së, të gjitha këto me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla apo të ngjashme.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në bazë të nenit 73 par.1 pika 2.2 të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087.

Vendimi për shpenzimet të procedurës kundërvajtjes paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 59 të Ligjit për Kundërvajtje 05/L-087.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË GRAQANICË-  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE**

**K.nr.292/2024, më datë 21.01.2025.**

**Gjyqtari:**

**Rrustem Begolli**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimimit në Gjykatën e Apelit, përmes kësaj gjykate